- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i

projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shpëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shpëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të

arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 617-25-1877-5-1-1/C839-2

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshimi ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% e vlerës së kontratës për periudhën deri më 30.04.2027 pastaj do të nënshkruhet kontrata .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	1. Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve 2. humbje ose dëmtim i Pajisjeve 3. humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) 4. dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit (ii) të personave të tjerë Përgjegjësi mbanë kontraktuesi (OE)
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda tri ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 19.05.2025
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha punëve do të jetë 31.03.2027
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	OE është i obliguar të mbaj regjistër të punës. OE është i obliguar që të vendos tabelën informuese (PANO) standarde me shenimet

		për projektin , investitorët dhe OE në vendëpunishte.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit emrohet nga ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mënyra e Pagesave	30.1	Bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë Mjedisit ,Planifikimit Hapsionor dhe Infrastruktura të këtij projekti nr.M-02-395 të datës 20.01.2025, të nënshkruar në mes zv.Ministrit Hysen Durmishi dhe Kryetarit të Komunes Qemajl Aliu,pagesa do të bëhet nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsionor dhe Infrastruktura,neni 3.3 i memorandumit,nga buxheti i vitit 2025 ,2026,2027 ,kodi i projektit 19662 . Pagesat OE,do t'i bëhen sipas situatave të punëve të përfunduara (Çertifikatave) të aprovuara nga menaxheri i kontratës. OE duhet të sjellë këto dokumente për pagesën e fundit : 1.Garancioni për punët e kryera për(12 muaj) 2.Raporti i pranimit teknik nga komisioni. 3.Situacioni përfundimtar . 4.Fatura e rregullt. 5.Raporti nga mbikqyrësi për përfundimin e punëve me plan dinamik
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	OE,është i obliguar të sjellë një garancion bankar ose nga kompania e sigurimit të vlerës së 10% të kontratës për periudhën 12 mujore nga data e pranimit teknik të projektit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve .AK do të bëjë pagesën e punëve të përfunduara , të vërtetuara nga menaxheri i kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Palet kontraktuese do të bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale , përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore .</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet lënda në gjykatën Kompetente .

Rivitalizimi dhe rregullimi i rrugëve në Shtime dhe fshatrat, Vojnovc, Rashincë, Mollopolc, Petrovë, Davidovc, si dhe në disa fshatra- Lot-II

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

ASFALTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN VOJNOVC ME GJATËSI TOTALE L=1185m, B=3m

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
PUNËT PËRGADITORE					
Vërejtje: Para përdorimit të materialeve si Zhavorit, gypave dhe elementeve tjera përbërëse, Operatori Shërbyes është i obliguar që:					
1.1	Të bëhet ingjizimi gjeodezik i trasesë, të bëhet pikëtimi dhe të nxirren kuotat e rrugës në bazë të matjeve të cilat i siguron nga terreni.	m ²	1,185.00	1.00€	1,185.00€
1.2	Pastrimi i rrugës, heqja e të gjitha materialeve të cilat gjenden në rrugë të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, Transporti i materialeve të grumbulluara gjatë pastrimit; duhet të transportohen deri në deponi 5km-sipa Menaxherit të Kontratës. Në këtë pozicion përfshihet heqja e shkurreve, drunjeve me diametër deri në 1m si dhe heqja e të gjitha llojeve të mureve dhe strukturave nga betoni dhe betoni i armuar.	m ²	1,185.00	1.00€	1,185.00€
NËNTOTALI:					2,370.00€
PUNËT TOKËSORE					
2.1	Gërmimi dhe heqja e shtresës së përzier zhavor/humus deri në nivelin e kërkuar, duke larguar materialin e paqëndrueshëm dhe duke arritur një bazë të fortë. Pastrimi dhe përgatitja e sipërfaqes do të kryhen me kujdes për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e bazamentit të rrugës.	m ³	1,422.00	3.50€	4,977.00€
2.2	Dheu i gërryer duhet të shpërndahet fillimisht brenda trasesë së rrugës për nivelim dhe stabilizim. Pas formimit përfundimtar të trasesë, materiali i tepërt do të transportohet dhe deponohet në lokacionin e përcaktuar, në përputhje me udhëzimet e menaxherit të kontratës.	m ³	1,185.00	2.00€	2,370.00€
2.3	Pas përfundimit të të gjitha procedurave të gërryerjes dhe planifikimit, toka duhet të ngjeshet deri në nivelin e duhur për të siguruar qëndrueshmëri dhe mbajtshmëri optimale. Vetëm pasi të arrihet kompaktësia e kërkuar, mund të fillojë procesi i shtrimit të zhavorit.	m ³	1,185.00	1.00€	1,185.00€
NËNTOTALI:					8,532.00€
PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS					
3.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 63-150 mm) do të realizohen sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar, duke siguruar një shpërndarje të njëtrajtshme për të garantuar qëndrueshmëri dhe stabilitet optimal të bazës.	m ³	100.00	15.00€	1,500.00€



3.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 0-63 mm) do të realizohen sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Trashësia përfundimtare e zhavorit, pas ngjeshjes, duhet të jetë 20 cm. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar në disa shtresa, duke siguruar që çdo shtresë të ngjeshet mirë përpara vendosjes së shtresës tjetër. Për të arritur një kompaktësi optimale, secila shtresë do të ujitet gjatë procesit të ngjeshjes, duke përmirësuar qëndrueshmërinë e bazës.	m ³	948.00	16.00€	15,168.00€
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 0-31.5 mm) do të realizohen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Trashësia përfundimtare e zhavorit, pas ngjeshjes, duhet të jetë 10 cm. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar në disa shtresa, duke siguruar që secila shtresë të ngjeshet në mënyrë të njëtrajtshme përpara vendosjes së shtresës pasuese. Për të arritur një kompaktësi optimale dhe stabilitet maksimal, çdo shtresë do të ujitet gjatë procesit të ngjeshjes. Ngjeshja e materialit duhet të arrijë një koeficient mbajtës prej 70 MN/m ² , duke rritur qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e strukturës së trupit të rrugës.	m ³	474.00	16.00€	7,584.00€
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit për mbushjen e Bankinave (fraksion 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrijë 18cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet dhe të formohet bankinat.	m ³	118.50	16.00€	1,896.00€
3.5	Operatori Shërbyes është obligativ për zhavorin me të cili do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës Atesti. Para asfaltimit duhet të dorëzohet raporti i modulit të ngjeshmërisë, dhe duhet të bëhet matja e trashësisë së zhavorit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	komplet	1.00	500.00€	500.00€
NETOTALI:					26,648.00€
4. PUNIMI I LËSHESAVE ME TUBACION					
4.1	Punimi i lëshesave gypore për kalimin e ujit nën rrugët lidhëse dhe vazhdimi i tyre në zgjerimin e rrugës me beton të armuar. Tubat do të jenë të mbështjellë me beton dhe do të kenë koka hyrëse dhe dalëse të realizuara nga betoni C25/30, duke përfshirë gjithashtu armimin e kokave për qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të lartë. Lshesat të jenë me dimension Ø400mm	m	40	40	1,600.00€
NETOTALI:					1,600.00€
5. NDRYSHIME DHE ZHVENDOSJE INSTALACIONESH					




5.1	Gjat punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusetave egzistuese, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusetat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusetë dhe ngritja e pusetës duhet të bëhet në mënyrë precize për të qenë në nivel të njejtë me asfalt. Kapaku i Pusetës duhet të furnizohet dhe montohet nga materiali i gizës 40Ton.	Copë	6.00	120.00	720.00€
5.2	Zhvendosja e shtyllave elektrike dhe shtyllave ndriqese publike. Gjatë punimeve duhet të tregohet kujdes i shtuar për të shmangur dëmtimin e rrjetit elektrik. Shtyllat e betonit dhe ato prej druri të rrjetit elektrik apo edhe për ndriqim publik duhet të zhvendosen në mënyrë që të mos pengojnë zhvillimin e punimeve të ndërtimit të rrugës. Në rastë prishjes ose dëmtimit përgjegjësi i mbete Punëkryesi-OE	Copë	1.00	100.00	100.00€
NËNTOTALI:					820.80€
6. HAPJA E KANALIT GJATËSOR PRAN RRUGËS					
6.1	Hapja e kanalit gjatësorë pran rrugës për largimin e ujrave atmosferike në formë rigolle.	m'	2,370.00	1.00€	2,370.00€
NËNTOTALI:					2,370.00€
7. PUNËT E ASFALTIT					
7.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e Asfalt Betonit AB 16, me trashësi t= 7 cm në gjendje të ngjeshur, sasia e perberjes së bituminit duhet të jetë e mjaftueshme sipas normave në mënyrë që asfalti të jetë mirë i lidhur dhe jo poroz. Në momentin e hüdhes në vepër dhe gjatë fazës fillestare të ngjeshjes materiali duhet ta ketë temperaturën mbi 130°C. Vërejtje: Punëkryesi është i obliguar që gjatë vendosjes së asfaltit të kujdeset që vijat anësore të asfaltit të mbesin të drejta si dhe pjerrtësia e kërkuar në detyrën projektuese të respektohet. Ngjeshja e asfaltit duhet të bëhet në distanca të caktuara sipas Menaxherit të Kontratës sa duhet të jetë cilindri në mesë Finisherit të Asfaltit.	m²	3,635.00	14.50€	52,707.50€
7.2	OSH është obligativ pas përfundimit të Asfaltimit me të cilin do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës (atesti marshall) i Asfaltit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	komplet	1.00	400.00€	400.00€
NËNTOTALI:					53,107.50€
8. PROJEKTI I REALIZIMIT					
8.1	Të gjitha matjet, p.sh. Profili Gjatësor, Tërthor, Vendndodhja e pusetave lëshesave si dhe të gjitha elementet përbërëse duhet të paraqiten në projekt të realizimit, dhe të dorëzohet te AK. Materiali duhet të jetë i shtypur dhe i lidhur në formë projekti në dy origjinale dhe elektronike - CD.	komplet	1.00	1,000.00€	1,000.00€
NËNTOTALI:					1,000.00€
REKAPITULIMI I RRUGËS					
1	PUNËT PËRGADITORE				2,370.00€
2	PUNËT TOKËSORE				8,532.00€



3	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS	26,648.00€
4	PUNËT E LËSHESAVE ME TUBACION	1,600.00€
5	NDRYSHIME DHE ZHVENDOSJE INSTALACIONESH	820.00€
6	HAPJA E KANALIT OJATËSOR PRAN RRUGËS	2,370.00€
7	PUNËT E ASPALTIT	53,107.50€
8	PROJEKTI I REALIZIMIT	1,000.00€
TOTALI		96,447.50€

REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM		
1	REKAPITULIMI I RRUGËS	96,447.50 €
TOTALI duke përfshirë të gjitha taksat:		96,447.50 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
ASPAITIMI I RRUGËVE NË FSHATIN RASHINÇ NË GJATËSI TOTALE: I - 1600m, II - 3m					
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	PUNËT PËRGADITORE				
Vërejtje: Para përdorimit të materialeve si Zhavorit, gypave dhe elementeve tjera përbërëse, Operatori Shërbyes është i obliguar që					
1.1	Të bëhet inçizimi gjeodezik i trasesë, të bëhet pikëtimi dhe të nxirren kuotat e rrugës në bazë të matjeve të cilat i sigurojnë nga terreni.	m'	1,600.00	1.00€	1,600.00€
1.2	Pastrimi i rrugës, heqja e të gjitha materialeve të cilat gjenden në rrugë të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, Transporti i materialeve të grumbulluara gjatë pastrimit, duhet të transportohen deri në deponi 5km sipa Menaxherit të Kontratës. Në keto pozicion përfshihet heqja e shkurreve, drunjeve me diametër deri në 1m si dhe heqja e të gjitha llojeve të mureve dhe strukturave nga betoni dhe betoni i armuar.	m'	1,600.00	1.00€	1,600.00€
NËNTOTALI:					3,200.00€
2	PUNËT POKESORË				
2.1	Gërmimi dhe heqja e shtresës së përzier zhavor/humus deri në nivelin e kërkuar, duke larguar materialin e paqëndrueshëm dhe duke arritur një bazë të fortë. Pastrimi dhe përgatitja e sipërfaqes do të kryhen me kujdes për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e bazamentit të rrugës.	m ³	1,920.00	3.50€	6,720.00€
2.2	Dheu i gërryer duhet të shpërndahet fillimisht brenda trasesë së rrugës për nivelim dhe stabilizim. Pas formimit përfundimtar të trasesë, materiali i tepërt do të transportohet dhe deponohet në lokacionin e përcaktuar, në përputhje me udhëzimet e menaxherit të kontratës.	m'	1,600.00	2.00€	3,200.00€
2.3	Pas përfundimit të të gjitha procedurave të gërryerjes dhe planifikimit, toka duhet të ngjeshet deri në nivelin e duhur për të siguruar qëndrueshmëri dhe mbajtshmëri optimale. Vetëm pasi të arrihet kompaktësia e kërkuar, mund të fillojë procesi i shtrimit të zhavorit.	m'	1,600.00	1.00€	1,600.00€
NËNTOTALI:					11,520.00€
3	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS				



3.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 63-150 mm) do të realizohen sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar, duke siguruar një shpërndarje të njëtrajtshme për të garantuar qëndrueshmëri dhe stabilitet optimal të bazës.	m ³	115.00	15.00€	1,725.00€
3.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 0-63 mm) do të realizohen sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Trashësia përfundimtare e zhavorit, pas ngjeshjes, duhet të jetë 20 cm. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar në disa shtresa, duke siguruar që çdo shtresë të ngjeshet mirë përpara vendosjes së shtresës tjetër. Për të arritur një kompaktësi optimale, secila shtresë do të ujitet gjatë procesit të ngjeshjes, duke përmirësuar qëndrueshmërinë e bazës.	m ³	1,280.00	16.00€	20,480.00€
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 0-31.5 mm) do të realizohen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Trashësia përfundimtare e zhavorit, pas ngjeshjes, duhet të jetë 10 cm. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar në disa shtresa, duke siguruar që secila shtresë të ngjeshet në mënyrë të njëtrajtshme përpara vendosjes së shtresës pasuese. Për të arritur një kompaktësi optimale dhe stabilitet maksimal, çdo shtresë do të ujitet gjatë procesit të ngjeshjes. Ngjeshja e materialit duhet të arrijë një koeficient mbajtës prej 70 MN/m ² , duke rritur qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e strukturës së trupit të rrugës.	m ³	560.00	16.00€	8,960.00€
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit për mbushjen e Bankinave (fraksion 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrijë 18cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet dhe të formohen bankinat.	m ³	160.00	16.00€	2,560.00€
3.5	Operatori Shërbyes është obligativ për zhavorin me të cili do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës. Atesti, Para asfaltimit duhet të dorëzohet raporti i modulit të ngjeshmërisë, dhe duhet të bëhet matja e trashësisë së zhavorit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	komplet	1.00	500.00€	500.00€
NËTOTALI:					34,225.00€
4. PUNËT E LËSHESAVE ME TUBACION					
4.1	Punimi i lëshesave gypore për kalimin e ujit nën rrugët lidhëse dhe vazhdimi i tyre në zgjerimin e rrugës me beton të armuar. Tubat do të jenë të mbështjellë me beton dhe do të kenë koka hyrëse dhe dalëse të realizuara nga betoni C25/30, duke përfshirë gjithashtu armimin e kokave për qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të lartë. Lëshesat të jenë me dimension Ø400mm	m	40	40	1,600.00€
NËTOTALI:					1,600.00€



5. PUNËT E NGRITJES SË PUSËTAVE					
5.1	Gjat punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusëtave egzistuese, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusëtat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusët dhe ngritja e pusëtës duhet të bëhet në mënyrë precize për të qenë në nivel të njejtë me asfalt. Kapaku i Pusëtës duhet të furnizohet dhe montohet nga materiali i gjzës 40Ton.	Copë	8.00	120.00	960.00€
5.2	Zhvendosja e shtyllave elektrike dhe shtyllave ndriqese publike. Gjatë punimeve duhet të tregohet kujdes i shtuar për të shmangur dëmtimin e rrjetit elektrik. Shtyllat e betonit dhe ato prej druri të rrjetit elektrik apo edhe për ndriqim publik duhet të zhvendosen në mënyrë që të mos pengojnë zhvillimin e punimeve të ndërtimit të rrugës. Në rastë prishjesë ose dëmtimit përgjegjësi i mbete Punëkryesi-OE	Copë	1.00	100.00	100.00€
NËNTOTALI:					1,060.00€
6. HAPJA E KANALIT GJATËSOR PRAN RRUGËS					
6.1	Hapja e kanalit gjatësorë pran rrugës për largimin e ujrave atmosferike në formë rigolle.	m'	3,200.00	1.00€	3,200.00€
NËNTOTALI:					3,200.00€
7. PUNËT E ASFALTIT					
7.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e Asfalt Betonit AB 16, me trashësi $t=7$ cm në gjendje të ngjeshur, sasia e perberjes së bituminit duhet të jetë e mjaftueshme sipas normave në mënyrë që asfalti të jetë mirë i lidhur dhe jo poroz. Në momentin e hüdhes në vepër dhe gjatë fazës fillestare të ngjeshjes materiali duhet ta ketë temperaturën mbi 130°C. Vërejtje: Punëkryesi është i obliguar që gjatë vendosjes së asfaltit të kujdeset që vijat anësore të asfaltit të mbesin të drejta si dhe pjerrtësia e kërkuar në detyrën projektuese të respektohet. Ngjeshja e asfaltit duhet të bëhet në distanca të caktuara sipas Menaxherit të Kontratës sa duhet të jetë cilindri në mesë-Finisherit të Asfaltit.	m²	4,880.00	14.50€	70,760.00€
7.2	OSH është obligativ pas përfundimit të Asfaltimit me të cilin do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës (atesti marshall) i Asfaltit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	komplet	1.00	400.00€	400.00€
NËNTOTALI:					71,160.00€
8. PROJEKTI I REALIZIMIT					
8.1	Të gjitha matjet, p.sh. Profili Gjatësor, Tërthor, Vendndodhja e pusëtave lëshesave si dhe të gjitha elementet përbërëse duhet të paraqiten në projekt të realizimit, dhe të dorëzohet te AK. Materiali duhet të jetë i shtypur dhe i lidhur në formë projekti në dy origjinale dhe elektronike -CD.	komplet	1.00	1,000.00€	1,000.00€
NËNTOTALI:					1,000.00€
REKAPITULIMI I RRUGËS					
1	PUNËT PËRGADITORE				3,200.00€




2	PUNËT TOKËSORE	11,520.00€
5	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS	34,225.00€
6	PUNËT E LËSHESAVE ME TUBACION	1,600.00€
7	PUNËT E NGRITJES SË PUSHTAVE	1,060.00€
8	HAPJA E KANALIT GJATËSOR PRAN RRUGËS	3,200.00€
9	PUNËT E ASFALTIT	71,160.00€
10	PROJEKTI I REALIZIMIT	1,000.00€
TOTALI		126,965.00€

REKAPITULIMI I PËRGJITHSHËM		
1	REKAPITULIMI I RRUGËS	126,965.00 €
TOTALI duke përfshirë të gjitha taksat:		126,965.00 €

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
ASFAITIMI I RRUGËVE NE FSHATIN MUOLLTOPOLC ME GJATESI TOTALE: L- 340m B- 3m L- 620m B- 5m					
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	PUNËT PËRGADITORE				
Vërejtje: Para përdorimit të materialeve si Zhavorit, gypave dhe elementeve tjera përbërëse, Operatori Shërbyes është i obliguar që					
1.1	Të bëhet inçizimi gjeodezik i trasesë, të bëhet pikëtimi dhe të nxirren kuotat e rrugës në bazë të matjeve të cilat i siguron nga terreni.	m'	960.00	1.00€	960.00€
1.2	Pastrimi i rrugës, heqja e të gjitha materialeve të cilat gjenden në rrugë të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, Transporti i materialeve të grumbulluara gjatë pastrimit, duhet të transportohen deri në deponi 5km sipa Menaxherit të Kontratës, Në këtë pozicion përfshihet heqja e shkurreve, drunjeve me diameter deri në 1m si dhe heqja e të gjitha llojeve të mureve dhe strukturave nga betoni dhe betoni i armuar.	m'	960.00	1.00€	960.00€
NËNTOTALI:					1,920.00€
2	PUNËT TOKËSORE				
2.1	Gërmimi dhe heqja e shtresës së përzier zhavor/humus deri në nivelin e kërkuar, duke larguar materialin e paqëndrueshëm dhe duke arritur një bazë të fortë. Pastrimi dhe përgatitja e sipërfaqes do të kryhen me kujdes për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e bazamentit të rrugës.	m ³	1,152.00	3.50€	4,032.00€
2.2	Dheu i gërryer duhet të shpërndahet fillimisht brenda trasesë së rrugës për nivelim dhe stabilizim. Pas formimit përfundimtar të trasesë, materiali i tepërt do të transportohet dhe deponohet në lokacionin e përcaktuar, në përputhje me udhëzimet e menaxherit të kontratës.	m'	960.00	2.00€	1,920.00€
2.3	Pas përfundimit të të gjitha procedurave të gërryerjes dhe planifikimit, toka duhet të ngjeshet deri në nivelin e duhur për të siguruar qëndrueshmëri dhe mbajtshmëri optimale. Vetëm pasi të arrihet kompaktësia e kërkuar, mund të fillojë procesi i shtrimit të zhavorit.	m'	960.00	1.00€	960.00€
NËNTOTALI:					6,912.00€
3	PUNËT E BAZAMENTIT TË RRUGËS				



3.1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 63-150 mm) do të realizohen sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar, duke siguruar një shpërndarje të njëtrajtshme për të garantuar qëndrueshmëri dhe stabilitet optimal të bazës.	m ²	100.00	15.00€	1,500.00€
3.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 0-63 mm) do të realizohen sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Trashësia përfundimtare e zhavorit, pas ngjeshjes, duhet të jetë 20 cm. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar në disa shtresa, duke siguruar që çdo shtresë të ngjeshet mirë përpara vendosjes së shtresës tjetër. Për të arritur një kompaktësi optimale, secila shtresë do të ujitet gjatë procesit të ngjeshjes, duke përmirësuar qëndrueshmërinë e bazës.	m ²	1,016.00	16.00€	16,256.00€
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit (fraksion 0-31.5 mm) do të realizohen në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Trashësia përfundimtare e zhavorit, pas ngjeshjes, duhet të jetë 10 cm. Zhavori do të shtrihet në të gjithë sipërfaqen e planifikuar në disa shtresa, duke siguruar që secila shtresë të ngjeshet në mënyrë të njëtrajtshme përpara vendosjes së shtresës pasuese. Për të arritur një kompaktësi optimale dhe stabilitet maksimal, çdo shtresë do të ujitet gjatë procesit të ngjeshjes. Ngjeshja e materialit duhet të arrijë një koeficient mbajtës prej 70 MN/m ² , duke arritur qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e strukturës së trupit të rrugës.	m ²	460.00	16.00€	7,360.00€
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit për mbushjen e Bankinave (fraksion 0-31.5mm). Trashësia e zhavorit duhet të arrihet 18cm pas ngjeshjes. Zhavori duhet të shtrihet dhe të formohen bankinat.	m ²	96.00	16.00€	1,536.00€
3.5	Operatori Shërbyes është obligativ për zhavorin me të cili do të punohet rruga, të dorëzohet menaxherit të kontratës Atest. Para asfaltimit duhet të dorëzohet raporti i modulit të ngjeshmërisë, dhe duhet të bëhet matja e trashësisë së zhavorit. Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	komplet	1.00	500.00€	500.00€
NËTOTALI:					27,152.00€
4. PUNET E LËSHESAVE ME TUBACION					
4.1	Punimi i lëshesave gypore për kalimin e ujit nën rrugët lidhëse dhe vazhdimi i tyre në zgjerimin e rrugës me beton të armuar. Tubat do të jenë të mbështjellë me beton dhe do të kenë koka hyrëse dhe dalëse të realizuara nga betoni C25/30, duke përfshirë gjithashtu armimin e kokave për qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të lartë. Lshesat të jenë me dimension Ø400mm	m'	25	40	1,000.00€
NËTOTALI:					1,000.00€



5. NDRYSHME DHE ZHVENDOSJE INSTALACIONESH					
5.1	Gjat punimeve duhet të ketë kujdes të shtuar për mos dëmtimin e pusetave egzistuese, dhe mbylljen e kanalizimit. Pusetat duhet të ngriten me beton duke bërë shabllon unik për çdo pusetë dhe ngritja e pusetës duhet të bëhet në mënyrë precize për të qenë në nivel të njëjtit me asfalt. Kapaku i Pusetës duhet të furnizohet dhe montohet nga materiali i gëzës 40Tøn.	Copë	5.00	120.00	600.00€
5.2	Zhvendosja e shtyllave elektrike dhe shtyllave ndriqese publike. Gjatë punimeve duhet të tregohet kujdes i shtuar për të shmangur dëmtimin e rrjetit elektrik. Shtyllat e betonit dhe ato prej druri të rrjetit elektrik apo edhe për ndriqim publik duhet të zhvendosen në mënyrë që të mos pengojnë zhvillimin e punimeve të ndërtimit të rrugës. Në rastë prishjesë ose dëmtimit përgjegjësi i mbete Punëkryesi-OE	Copë	2.00	100.00	200.00€
NËNTOTALI:					800.00€
6. HAPJA E KANALIT GJATËSOR PRAN RRUGËS					
6.1	Hapja e kanalit gjatësorë pran rrugës për largimin e ujrave atmosferike në formë rigolle .	m'	1,920.00	1.00€	1,920.00€
NËNTOTALI:					1,920.00€
7. PUNËT E ASFALTIT					
